



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 04/39 Prot

Tiranë, më 08.01.2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT SHKELQIM ZURIQI

Nr. 6 datë 22.12.2023

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Klevis Dhigoi	Kryesues
Erjana Pjetri	Relator
Ersa Karaj	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretare e Sekretariatit Teknik, Znj. Ersila Kalaja, në orën 09:00 datë 22.12.2023, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Shkelqim Rexhep Zuriqi**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar,

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes Erjana Pjetri, dëgjoji subjektin e vlerësimit Shkelqim Rexhep Zuriqi, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 22.12.2023, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të Ligjit 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, shtetasi Shkelqim Rexhep Zuriqi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023 si Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
3. Subjekti i vlerësimit, Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 *“Për procedurat e hedhjes së shortit”*.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 4/2, datë 18.4.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Z. Klevis Dhigoi Kryesues, Znj. Erjana Pjetri Relatore dhe Znj. Ersa Karaj Anëtare.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 *“Për hapat procedural të unifikuar”* me Vendimin Nr. 4/2, datë 18.4.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi.

6. Relatori i çështjes, Znj. Erjana Pjetri, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 19.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit si më poshtë vijon:
 - a. Me shkresën Nr.***Prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit Deklaratën e Pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. Me shkresën Nr.***Prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Financës dhe Burimeve Mbështetëse në Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deklaratën e vlerësimit të Aftësive Profesionale;
 - c. Me shkresën Nr.***Prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deklaratën e Kontrollit të Figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - vlerësimin e pasurisë;
 - kontrollin e figurës;
 - vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
- d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
- e. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
- g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

13. Gjithashtu, trupa e vlerësimit, ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- Deklaratën e Pasurisë;
- Deklaratën e Kontrollit të Figurës;
- Formularin e Vlerësimit Profesional;
- Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.
- Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI;
- Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP;
- Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga AMP;
- Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.

14. Trupa e vlerësimit, më datë 1.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Zuriqi me Vendim Nr. 3, datë 1.12.2023, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
 - Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-

47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 6 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
16. Në datën 15.12.2023 trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 22.12.2023, në orën 09:00, Salla e Mbledhjeve kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjin 12/2018, i ndryshuar.

II.SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Shkelqim Zuriqi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të përfaqësohet vetëm në këtë seance, pa mbrojtës ligjor. Në fund të seancës dëgjimore datë 22.12.2023, subjekti i vlerësimit, Shkelqim Zuriqi kërkoi konfirmimin në detyrë. Më datën 22.12.2023, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III.QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit Shkelqim Zuriqi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

17. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
18. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Shkelqim Zuriqi** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 10.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. 26, datë 10.3.2023.

19. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
20. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
21. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

❖ **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarameteve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameteve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

A/1. DEKLARIMI I PASURIVE

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik*”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave*”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raport¹ të

¹ Raporti nr. ***, datë 31.07.2023, i ILDKPKI-së.

hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Zuriqi, ku është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

22. Bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018 12/2018, i ndryshuar; (ç) deklaramet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;

23. Trupa Vlerësuese hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshur, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameteve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameteve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

Trupa e Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;

- a) deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- b) aktin përfundimtar të kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI;
- c) dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore nga instiucionet private dhe publike;
- d) dokumentacioni i administruar nga deklaramet e subjektit dhënë Trupës së Vlerësimit dhe ILDKPKI-së si përgjigje të pyetjeve të dërguara në rrugë zyrtare.

24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kërkuar të dhëna nga institucione publike dhe private të cilat në bazë të ligjit janë të detyruara të japin të dhëna. ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u është drejtuar institucioneve të mëposhtme:

- Agjensia Shtetërore e Kadastrës
- Drejtoritë Vendore në rreth dhe Zyrat Vendore të ASHK
- ISSH
- FSHU
- 15 Shoqëri Rajonale Ujësjellës – Kanalizime.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- QKB.
- Regjistri Noterial Shqiptar.

25. “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nentit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

 **Në deklaratën e pasurisë, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:**

Pasuria Nr. 1

Apartament, me sipërfaqe 25.20 m², i ndodhur në lagjen nr. 13, Plazh, “Shkëmbi i Kavajës”, Durrës, blerë në vitin 2008, në shumën 8.520 euro. Nr. pasurie ***. Certifikata për vërtetimin e pronësisë nr. ***, datë 30.07.2013. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga kursimet familjare dhe të punës. Vlera: 8.520 euro. **Pjesa takuese** 100%.

➤ ***Bashkëlidhur deklaratës***

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 30.07.2013, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit apartament me sipërfaqe 25.50 m², e ndodhur në rrugën “Plazh/13” Durrës, regjistruar në pronësi të Shkelqim Zuriqi.
- ✓ Kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit apartament me sipërfaqe 25.50 m², e ndodhur në rrugën “Plazh/13” Durrës, regjistruar në pronësi të Shkelqim Zuriqi, në datën 10.2.2009. Referuar përshkrimit të veçantë: “Rivlerësuar në datën 30.07.2013, RVP, në vlerën 1.320.000 lekë”.
- ✓ Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.12.2008, me blerës Shkelqim Zuriqi dhe shitës shoqëria “****” sh.p.k, për blerjen e apartamentit të ndodhur në katin përdhe me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, me adresë: Lagjia nr. 13, Plazh, Durrës, në vlerën e likuiduar prej 8.520 euro.
- ✓ Kontratë shitblerje me kusht nr. *** rep., *** kol., datë 7.8.2013, me shitës Shkelqim Zuriqi dhe blerës F. S, për shitjen me kusht të apartamentit me nr. pasurie nr. ***, vol. ***,

faqe ***, zk ***, e llojit apartament me sipërfaqe 25.50 m², e ndodhur në rrugën “Plazh/13” Durrës, në vlerën sipas rivlerësimit prej 1.320.000 lekë, nga të cilat shuma prej 200.000 lekë është likuiduar dhe shuma prej 1.120.000 lekë do të likuidohet në datën 20.1.2014 dhe në rast të mosplotësimit të kushteve sa më sipër për pagimin e shumës brenda afatit, shuma e likuiduar prej 200.000 lekë nuk do të rikthehet dhe kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.

Hetimi administrativ:

ASHK (online), konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e ndodhur në Durrës, regjistruar në pronësi të Shkelqim Zuriqi, me përshkrimin “...në datë 30.07.2013, kryer RVP me vlerën 1.320.000 lekë...”, me status “aktive”.

ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. ***prot., datë 3.7.2023, konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, të llojit apartament, në pronësi të Shkelqim Zuriqi. B/lidhur praktikës:

- ✓ Kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit apartament me sipërfaqe 25.5 m², me adresë: Plazh/13, Durrës, regjistruar në pronësi të Shkelqim Zuriqit, në datë 10.2.2009, me përshkrim “...në datë 30.7.2013, kryer RVP me vlerën 1.320.000 lekë...”.
- ✓ Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.12.2008, me blerës Shkelqim Zuriqi dhe shitës shoqëria “****”, sh.p.k, për blerjen e apartamentit të ndodhur në katin përdhe me nr. Pasurie ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, me adresë: Lagjia nr. 13, Plazh, Durrës, në vlerën e likuiduar prej 8.520 euro.

Në Proces-verbalin e datës 30.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

“Konfirmoj sa më sipër deklaruar duke sqaruar se për rivlerësimin e pasurisë janë paguar tarifatat përkatëse rreth 2% për vlerën e shtuar për të cilat për shkak të kohës së kaluar nuk disponoj dokumentacionin justifikues. Gjithashtu konfirmoj se likuidimi i shumës 200.000 lekë për kontratën e datës 7.8.2013, është kryer cash jashtë sistemit bankar dhe shitja e banesës nuk është realizuar për arsye të palës blerëse”.

Në Proces-verbalin e datës 20.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet në lidhje me shpenzimet e mobilimit për pasurinë e sipërcituar, subjekti sqaroi se:

“Mobilimi i apartamenti në plazh është kryer para 14 vitesh, duke u mobiluar me sende të përdorura me vlerë rreth 50.000 lekë, për të cilat nuk disponoj dokumentacion vërtetues për shkak të kohës së largët”.

FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Ujësjellës Kanalizime Durrës, me shkresë nr.***prot., datë 16.5.2023, nuk figurojnë abonentë të SHRUKD sh.a të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

26. **Trupa e vlerësimit**, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare të personave të lidhur me subjektin si dhe vlerësimin e mundësisë për mbulimin e shpenzimeve për asetin e mësipërm kreu analizën financiare si më poshtë vijon:

Të ardhurat për periudhë	Përshkrimi i të ardhurave	Të ardhura (Lekë)	Data e shpenzimeve	Shpenzimet	Përshkrimi i shpenzimeve
1995 - 2008	Të ardhura neto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit subjekti + bashkëshortja	4,897,092	1995 - 2008 ²	3,631,855	Apartament , me sipërfaqe 25.20 m ² , i ndodhur në lagjen nr. 13, Plazh, “Shkëmbi i Kavajës”, Durrës, blerë në vitin 2008, në shumën 8.520 ³ Euro
1995 - 2008	Të ardhurat totale	4,897,092	3,631,855	Shpenzime totale	
		4,897,092 – 3,631,855 = 1,265,237 kursim neto			

27. Nga analiza financiare rezultoi se gjendja balancë e të ardhurave nga paga/shpërblime dhe kursime të subjektit si dhe familjarëve tij është në vlerën rreth 1,265,237 lekë. Si përfundim, Trupa e Vlerësimit, nga hetimi administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklarimeve

² Në mungesë të pasqyrimin nga INSTAT për shpenzimet jetike për vitet 1995 – 1999, shpenzimet do të merren duke u përlogaritur sipas të dhënave për vitin pasardhës. Konkretisht viti 2000.

³ Referuar kursit mesatar të këmbimit valuator të vitit 2008.

të subjekti me dokumentacionin e administruar nga trupa e vlerësimit dhe nga ILDKPKI, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërinë nga ana financiare konstatohet se:

- ✓ **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.**

Pasuria Nr. 2

Ndërtesë (Garazh/depo), me sipërfaqe 51 m², e ndodhur në lagjen “Kodra” Shijak, Durrës, ndërtuar në vitet 2000 – 2015, hipotekuar me proces legalizimi me vlerë ndërtimi 300.000 lekë. Nr. pasurie ***. Certifikata për vërtetimin e pronësisë nr. ***, datë 6.9.2016. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga kursimet familjare dhe të punës. Vlera: 300.000 lekë. **Pjesa takuese 100%.**

➤ ***Bashkëlidhur deklaratës***

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 6.09.2016, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 51 m², e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në pronësi të Shkelqim Zuriqit.

Hetimi administrativ:

ASHK, me shkresën nr. *** prot., datë 12.6.2023, konfirmon se nga verifikimi digjital të vendimeve të legalizimit, rezulton se Shkelqim Rexhep Zuriqi është pajisur me vendim legalizimi nr. ***, datë 27.7.2016, për godinë banimi 1-kat, në Shijak.

ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2023, konfirmon se në emër të Shkelqim Zuriqi, rezulton: Leje Legalizimi nr. ***, datë 27.7.2016, për “Godinë banimi 1 kat”.

B/lidhur praktikës: Leje legalizimi nr. ***, datë 27.7.2016, në emër të Shkelqim Zuriqi, për godinë banimi 1 kat, të ndodhur në Shijak, me nr. pasurie ***, zk ***, me sipërfaqe 51 m² dhe me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 205m².

→**Në Proces-verbalin e datës 27.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

Subjekti ka sqaruar se: “vlera 300.000 lekë është deklaruar me përafërsi, duke llogaritur edhe shpenzime të tjera të mirëmbajtjes së objektit për të cilat nuk disponon dokumentacion. Lidhur me klasifikimin e objektit, subjekti sqaroi se legalizimi si godinë 1-kat është kryer nga ALUIZNI, pasi qëllimi fillestar i ndërtimit ka qenë përshatja në vijim për banim, e cila nuk është realizuar, duke

saktësuar se pasuria është përdorur nga babai i tij për aktivitetin e riparim të elektroshtëpiake dhe aktualisht funksionon si depo/garazh”.

→Në inventarin nr. extra prot., datë 27.6.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Situacionin e vlerësimit të objektit, me vlerë rreth 250.184 lekë.
- Fotografi të objektit, të paraqitur si depo/garazh.

→**Në proces-verbalin e datës 30.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me pasurinë e sipërcituar;...subjekti ka sqaruar se për parcelën ndërtimore, nuk ka përfituar akoma pronësinë, pasi nuk ka likuiduar shumën përkatëse sipas VKM-së Nr. 89, datë 8.2.2017 “Për kalimin e së drejtës së pronësisë për parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompesimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre”.

→Me inventarin nr.extra prot., datë 30.6.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Leje legalizimi nr. ***, datë 27.7.2016, në emër të Shkëlqim Zuriqi, për godinë banimi 1 kat, të ndodhur në Shijak, me nr. pasurie ***, zk ***, me sipërfaqe ndërtimi 51 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 205 m².

FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Ujësjellës Kanalizime Durrës, me shkresë nr.***prot., datë 16.5.2023, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë abonentë të SHRUKD sh.a.

Bazuar në deklaratimet e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, hetimin e kryer nga trupa e vlerësimit si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, rezulton se:

- ❖ Godina 1 kat me sipërfaqe 51 m² në Shijak, Durrës, e legalizuar dhe regjistruar në vitin 2016, që përdoret si depo/garazh, është ndërtuar gjatë periudhës 2000-2015, me vlerë totale investimi rreth 300.000 lekë, me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare. Kjo godinë është ndërtuar në parcelen ndërtimore me sipërfaqe 205 m², evidentuar në lejen e legalizimit, por akoma e paregjistruar.

28. Trupa e Vlerësimit, në lidhje me pasurinë e sipërcituar, referuar dhe tabelës financiare ku gjendja balancë e të ardhurave nga paga/shpërblime dhe kursime të subjektit është në vlerën rreth 1,265,237 lekë. Referuar dhe periudhës prej 15 vitesh (2000 – 2015) për ndërtimin e depo/garazh si dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së tij dhe mos vënies së pasurive të tjera, Trupa e Vlerësimit, nga hetimi administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaratimit

të subjekti me dokumentacionin e administruar nga trupa, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërinë nga ana financiare konkludoi se:

- ✓ **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;**

Pasuria Nr. 3

Banesë me sipërfaqe 139 m², e ndodhur në lagjen “Kodra”, Shijak, Durrës. Nr. pasurie ***. Certifikata për vërtetimin e pronësisë nr. ***, datë 1.12.2016, me pronar babain tim, të ndjerin Rexhep Zuriqi. **Burimi i krijimit:** Me trashëgimi ligjore. Vlera: 0 lekë. **Pjesa takuese 10%.**

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 1.12.2016, për pasurinë nr. ***, vol. 4, faqe ***, zk ***, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 139 m², e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në pronësi të Rexhep Zuriqi.
- ✓ Certifikatë vdekje (nga Akti), ku vërtetohet ndarja nga jeta në datën 22.4.2020, të të ndjerit Rexhep Zuriqi, sipas aktit të vdekjes nr. ***, datë 4.5.2020.
- ✓ Vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., me nr. *** kol., datë 12.12.2020, për trashëgimlënësin Rexhep Zuriqi dhe trashëgimtarë ligjor bashkëshorten Sh. Z, djalin Shkelqim Zuriqi, vajzën M. H, djalin A. Z dhe vajzën M. S, të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë secili.

✚ **Hetimi administrativ:**

ASHK (online), konfirmonë pasurinë nr. ***, vol. ***, faqa ***, zk ***, e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në bashkëpronësi të Sh. Z, Shkelqim Zuriqi, T. H, A. Z dhe M. S, me status “aktive”.

ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2023, konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, të llojit ndërtesë, në bashkëpronësi të Shkelqim Zuriqi.

➤ **Bashkëlidhur praktikës:**

→Kartela e pasurisë nr. ***, zk ***, e llojit ndërtesë me sip. 139 m², me adresë: Rr. “Dum Alla”, Shijak, në bashkëpronësi të Sh. Z, me pjesë takuese 6/10 si dhe Shkelqim Zuriqi, T. Hushi, A. Z dhe M. Smoqi, me pjesë takuese 1/10 secili, regjistruar në datë 21.1.2021, sipas Dëshmisë së Trashëgimisë nr. ***, datë 12.12.2020.

→Vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2020, për trashëgimlënësin Rexhep Zuriqi dhe trashëgimtarë ligjorë bashkëshorten Sh. Z, djalin Shkelqim Zuriqi, vajzën M. H djalin A. Z dhe vajzën M. S, të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë secili.

→Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 1.12.2016, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 139 m², e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në pronësi të Rexhep Zuriqi.

→**Në Proces-verbalin e datës 20.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

Në lidhje me pasurine nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit ndërtesë me sipërfaqe 139 m², subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me pjesën takuese, vlerën e asetëve që ka përfituar me trashëgimi ligjore nga i ndjeri babai i tij Rexhep Zuriqi.

Gjithashtu, subjekti është pyetur nëse ka kontribuar në arredimin e banesës, i cili ka deklaruar se:
- *“Mobilimi i banesës me sipërfaqe 139 m², është kryer nga prindërit dhe nuk ka djener për vlerën”*.

Referuar kontratës noteriale Nr Rep ***, datë 12.12.2020, me objekt “Lëshimi i Trashëgimisë Ligjore, i të ndjerit Rexhep Zuriqi”, ku është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Rexhep Zuriqi, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të poshtëshënuarit:

1. Sh. Z- bashkëshortja e trashëgimlënësit-në masën 1/5 pjesë;
2. Shkelqim Rexhep Zuriqi- djali i trashëgimlënësit-në masën 1/5 pjesë;
3. M. H- vajza e trashëgimlënësit-në masën 1/5 pjesë;
4. A. Z- djali i trashëgimlënësit-në masën 1/5 pjesë.
5. M. S- vajza e trashëgimlënësit-në masën 1/5 pjesë.

ASHK, konfirmon se akti i fitimit të pronësisë është me Dëshmi Trashëgimie, për pasurinë lloji Ndërtesë, nr. pasurie ***, sipërfaqe totale 139 m² nga të cilat truall 0 m², ndërtesë 139 m², Nr. ***, datë 12.12.2020, regjistruar me Nr. ***, datë 21.01.2021, në bazë të titullit të pronësisë, rezulton:

1. Sh. Z- bashkëshortja e trashëgimlënësit-në masën 6/10 pjesë;
2. Shkelqim Rexhep Zuriqi- djali i trashëgimlënësit-në masën 1/10 pjesë;
3. M. H- vajza e trashëgimlënësit-në masën 1/10 pjesë;
4. A. Z- djali i trashëgimlënësit-në masën 1/10 pjesë.
5. M. S- vajza e trashëgimlënësit-në masën 1/10 pjesë.

Subjekti i vlerësimit Shkelqim Zuriqi, ka dorëzuar dokumentacionin:

→Shkurtim vendimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku rezulton se me vendimin civil të formës prerë nr. 234, datë 26.03.1981, është vendosur vërtetimi i faktit juridik, se shtetasi Rexhep Zuriqi është pronar i një shtëpie banimi 1-katëshe, e ndodhur në Lagjen Kodër, Shijak.

→Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2016, me deklarues Rexhep Zuriqi, i cili deklaroi se ka patur të ndërtuar një ndërtesë me nr. Pasurie ***, vol ***, faqe ***, zk ***, Shijak, të cilën e ka shëmbur dhe ka ndërtuar një godinë banimi 1-kat, për të cilën është pajisur me Leje Legalizimi dhe ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie në emër të tij.

→Leje legalizimi nr. ***, datë 27.7.2016, në emër të Rexhep Zuriqi, për godinën banimi 1-kat, e ndodhur në Shijak, me nr. pasurie ***, zk***, me sipërfaqe ndërtimi 139 m² dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 418 m².

FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Ujësjellës Kanalizime Durrës, me shkresë nr.***prot., datë 16.5.2023, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë abonentë të SHRUKD sh.a.

Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, hetimin e krver nga trupa e vlerësimit si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, rezulton se:

29. *Godina e banimit 1-kat, me sipërfaqe 139 m², në Lagjen Kodra, Shijak, Durrës, është përfituar nga subjekti me dëshmi trashëgimie ligjore të babait të tij në vitin 2020, me pjesë takuese 10%. Subjekti ka deklaruar se pavarësisht se aktualisht banon në këtë banesë, nuk ka patur kontribut financiar për ndërtim apo investime.*

✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

Pasuria Nr. 4

Njësi me sipërfaqe 38.2 m², e ndodhur në lagjen “Kodra”, Shijak, Durrës. Nr. pasurie ***. Certifikata për vërtetimin e pronësisë nr. ***, datë 23.12.2016, me pronar babain tim, të ndjerin Rexhep Zuriqi. **Burimi i krijimit:** Me trashëgimi ligjore. Vlera: 0 lekë. **Pjesa takuese** 10%.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 23.12.2016, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit njësi, me sipërfaqe 38.2 m², e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në pronësi të Rexhep Zuriqi.
- ✓ Certifikatë vdekje (nga Akti), ku vërtetohet ndarja nga jeta në datën 22.4.2020, të shtetasit Rexhep Zuriqi, sipas aktit të vdekjes nr. ***, datë 4.5.2020.
- ✓ Vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., me nr. *** kol., datë 12.12.2020, për trashëgimlënësin Rexhep Zuriqi dhe trashëgimtarë ligjor bashkëshorten

Sh. Z, djalin Shkelqim Zuriqi, vajzën M. H, djalin A. Z dhe vajzën M. S, të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë secili.

Hetimi administrativ:

ASHK (online), konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqa ***, zk ***, e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në bashkëpronësi të Sh. Z, Shkelqim Zuriqi, T. H, A. Z dhe M. S, me status “aktive”.

ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2023, konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, të llojit njësi, në bashkëpronësi të Shkelqim Zuriqi.

B/lidhur praktikës:

→Kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit njësi me sip. 38.2 m², me adresë: Shijak, në bashkëpronësi të Sh. Z, Shkelqim Zuriqi, T. H, A. Z dhe M. S, regjistruar në datë 25.1.2021, sipas Dëshmisë së Trashëgimisë nr. ***, datë 12.12.2020.

→Vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2020, për trashëgimlënësin Rexhep Zuriqi dhe trashëgimtarë ligjorë bashkëshorten Sh. Z, djalin Shkelqim Zuriqi, vajzën M. H djalin A. Z dhe vajzën M. S, të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë secili.

→Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 23.12.2016, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit njësi me sipërfaqe 38.2 m², e ndodhur në Shijak, Durrës, regjistruar në pronësi të Rexhep Zuriqi.

→**Në Proces-verbalin e datës 27.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

Subjekti sqaroi se: “...Pasuria e llojit Njësi e trashëguar nga babai, me pjesë takuese 10% është blerë fillimisht nga Ndërmarrja Rajonale e Shërbimeve Shijak dhe në vijim është pjestuar sipas kontratës datë 4.11.2016, duke saktësuar se nuk ka patur asnjë kontribut në krijimin dhe në vijim në investimin për përmbajtjen e kësaj pasurie si dhe nuk përfiton të ardhura...”

FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Ujësjellës Kanalizime Durrës, me shkresë nr.***prot., datë 16.5.2023, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë abonentë të SHRUKD sh.a.

30. **Nga analizimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga vet subjekti i vlerësimit, rezulton se:**

Në bazë të kontratës së shitblerjes datë 8.4.1994, me blerës Rexhep Zuriqi dhe shtetasin N. Sh, shitës NRSH Shijak, për blerjen e pasurisë së llojit “Lokal riparimi elektroshtëpiake”, me sipërfaqe 57.5 m², me vlerë likuiduar prej 60.330 Lekë. I ndjeri Rexhep Zuriqi dhe shtetasi N. Sh, kanë hartuar kontratë për pjestim pasurie të paluajtshme. Me nr. *** rep, nr. kol ***, datë 4.11.2016 për pjestimin e pasurisë nr.***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e ndodhur në Shijak, Durrës, pasuri e llojit “Njësi” totale 57.5 m², ku nga pjesëtimi i kësaj pasurie të paluajtshme i ndjeri Rexhep Zuriqi ka përfituar pasurinë nr.***, me sipërfaqe 38.2 m².

Pasuria e paluajtshme “Njësi”, me sipërfaqe 38.2 m², në Shijak, Durrës, është përfituar nga subjekti me dëshmi trashëgimie ligjore të babait të tij në vitin 2020, me pjesë takuese 10%. Subjekti ka deklaruar se pavarësisht se aktualisht banon në këtë banesë, nuk ka patur kontribut financiar për ndërtim apo investime.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

Pasuria Nr. 5

Automjet, tip Citroen, vit prodhimi 2004, me targë AA***IX, blerë në vitin 2014. Certifikata e pronësisë së mjetit nr. ****. **Burimi i krijimit:** të ardhurat nga kursime familjare. Vlera: Blerje 900 euro dhe zhdoganim 37.789 lekë. **Pjesa takuese 100%.**

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Dokumentacion në gjuhën italiane, për blerjen nga Shkelqim Zuriqi, të automjetit tip Citroen C3, në vlerën 900 euro, në datë 4.3.2014.
- ✓ Dokumentacioni i importimit të automjetit tip Citroen C3, vit prodhimi 2004.
- ✓ Certifikata e pronësisë së mjetit nr. ***, datë 20.03.2014, për automjetin tip Citroen C3, me nr. shasie **** dhe targë AA***IX, regjistruar në pronësi të Shkelqim Rexhep Zuriqi, sipas aktit datë 4.3.2014.
- ✓ Kontratë mbi shitblerjen e automjetit e lidhur pranë DPSHTRR-së, me nr. *** regj., datë 4.4.2019, me shitës Shkelqim Zuriqi dhe blerës K. S, për shitjen e automjetit tip Citroen C3, me nr. shasie **** dhe targë AA***IX, në vlerën e likuiduar prej 200.000 Lekë.

Hetimi administrativ:

DPSHTRR, me shkresë nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Shkelqim Zuriqi ka patur në pronësi automjetin me targë AA***IX.

- Autovërtetim i datës 4.3.2014, ku vërtetohet se shtetasi C. C, banues në Itali, i ka shitur shtetasit Shkelqim Zuriqi, banues në Shqipëri, automjetin tip Citroen C3, me nr. shasje ****, në vlerën 900 euro.
- Kontratë nr. *** regj., datë 4.4.2019, lidhur më DPSHTRR Durrës, me shitës Shkelqim Zuriq dhe blerës K. S, për shitjen e automjetit tip Citroen C3, me targë AA***IX, me nr. shasje ****. Vlera 200.000 lekë, e likuiduar.

→ **Në proces-verbalin** e datës 20.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

Lidhur me shitjen e automjetit tip Citroen, subjekti sqaroi se: *“lidhur me shitjen e automjetit tip Citroen, vlera e shitjes është e përfunduar me vlerën e blerjes së automjetit, duke shtuar vlerën e detyrimeve doganore të paguar dhe vlerën e investuar për disa riparime, për të cilat aktualisht, për arsye të tjetërsimit të pronësisë, nuk disponoj dokumentacion justifikues”*.

31. **Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:** Automjeti tip Citroen me targë AA***IX, është blerë në vitin 2014 në vlerën 900 euro, dhe shitur në vitin 2019 në vlerën 200.000 lekë. Nga ana e subjektit janë paguar detyrimet doganore dhe është investuar me riparimet e nevojshme, me burime financiare kursime nga të ardhurat familjare.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

Pasuria Nr. 6

Automjet tip Toyota, vit prodhimi 2007, blerë në vitin 2018. Certifikata e pronësisë së automjetit nr. ****, datë 12.12.2018. **Burimi krijimit:** Shitja e autoveturës tip Citroen me targë AA***IX, vit prodhimi 2004, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 4.4.2019, në shumën 200.000 (marrë paradhënie nga blerësi, në mirëbesim) dhe pjesa tjetër nga kursimet familjare. Vlera: 210.000 Lekë. Pjesa takuese 100%.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Faturë tatimore shitje nr. ***, datë 8.12.2018, me blerës Shkelqim Zuriqi dhe shitës “****”, sh.p.k, për blerjen e automjetit tip Toyota Yaris, me nr. shasje ****, në vlerën 210.000 lekë.
- ✓ Certifikata e pronësisë së mjetit nr. ****, datë 12.12.2018, për automjetin tip Toyota Yaris, me nr. shasje **** dhe targë AA***VS, regjistruar në pronësi të Shkelqim Rexhep Zuriqi, sipas faturës datë 8.12.2018.

- ✓ Kontratë mbi shitblerjen e automjetit e lidhur pranë DPSHTRR-së, me nr. *** regj., datë 4.4.2019, me shitës Shkelqim Zuriqi dhe blerës K. S, për shitjen e automjetit tip Citroen C3, me nr. shasie **** dhe targë AA *** IX, në vlerën e likuiduar prej 200.000 lekë.

Hetimi administrativ:

DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, konfirmon se Shkelqim Zuriqi ka të regjistruar në pronësi, automjetin me targë AA***VS.

- Kontratë shitje datë 8.12.2018, ku shtetasi E. J, administrator i Firmës “****” shpk, deklaroi se i ka shitur shtetasit Shkelqim Zuriqi, automjetin tip Toyota Yaris me nr. shasie ****, në vlerën 210.000 lekë, sipas faturës tatimore nr. **, datë 8.12.2018.

- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 8.12.2018, me blerës Shkelqim Zuriqi dhe shitës “****” shpk, për blerjen e automjetit tip Toyota Yaris, me nr. shasie ****, në vlerën 210.000 lekë.

→**Në proces-verbalin e datës 20.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

Lidhur me likuidimin e vlerës së shitjes së automjetit tip Citroen C3, subjekti ka konfirmuar sipas deklarimit, se shuma 200.000 lekë ka shërbyer si burim financiar për blerjen e automjetit tip Toyota.

→**Në inventarin nr.extra prot., datë 27.6.2023, subjekti ka dorëzuar:**

- Deklaratë noteriale nr. **** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2023, me deklarues shtetasen K. S, e cila deklaroi se gjatë vitit 2018, ka vendosur të blejë një automjet tip Citroen C3, nga daja e saj Shkelqim Zuriqi, i cili po shikonte mundësinë e blerjes së një automjeti tjetër dhe për shkak të lidhjes familjare dajë-mbesë, është kryer pagesa në fund të muajt Nëntor 2018, ndërkohë që kontrata noteriale shitblerjes është lidhur në muajt Prill 2019.

*****Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar , në mënyrë të përmbledhur rezultoi se;**

Automjeti tip Toyota me targë AA***VS, është blerë në vitin 2018, në vlerën 210.000 lekë, me burim financiar likuidimin paraprakisht të shumës 200.000 lekë, nga shitja e automjetit tip Citroen, me targë AA***IX dhe kursimet nga të ardhurat financiare.

32. **Në zbatim të pikës 1.1 të nenit 32 të ligjit 12/2018 i ndryshuar**, nga ku del detyrimi i subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të që të justifikojnë burimin e krijimit të pasurive trupa e vlerësimit analizoi mbi mundësinë e blerjes së mjetit tip Toyota me targë AA***VS, blerë në vitin 2018, në vlerën 210.000 lekë, me burim financiar të ardhurat e

krijara nga shitja e automjetit tip Citroen, me targë AA *** IX në vitin 2018, në vlerën 200.000 lekë dhe nga kursimet nga të ardhurat financiare.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✚ Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se jashtë sistemit bankar gjendje Cash: **Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese 100%.**
- ✓ **Të ardhurat e realizuara ndër vite nga paga/shpërblimet dhe kursimet familjare justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.**

A/2. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

33. Subjekti i vlerësimit Shkelqim Zuriqi në Deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar ka deklaruar:

- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe dieta nga puna si Oficer Policie në Komisaratin e Policisë Mirditë, për periudhën 1.9.1988 deri në 31.12.1991. *Nuk ka të dhëna të regjistruara.* Sipas vërtetimit për pagën, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë. Shuma sipas llogaritjeve: 40 muaj * 680 Lekë = 27.200 lekë
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe dieta nga puna si Oficer Policie në Komisaratin e Policisë Mirditë, për periudhën 1.1.1992 deri në 30.4.1993. Sipas vërtetimit për pagën, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë. Shuma: 71.600 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe dieta nga puna si Oficer Policie në Drejtorinë e Policisë Durrës, për periudhën 1.5.1993 deri më 1.11.1994. *Nuk ekzistojnë të dhëna të regjistruara.* Sipas vërtetimit për pagën, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Shuma sipas llogaritjeve: 18 muaj * 5.796 Lekë = 104.328 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe dieta nga puna si Oficer Policie në Drejtorinë e Policisë Durrës, për periudhën 1.11.1994 deri më 30.4.2005. Sipas vërtetimit për pagën, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Shuma 2.659.612 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe dieta nga puna si Oficer Policie në Drejtorinë e Policisë Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shteti dhe Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Durrës, për periudhën 11.5.2005 deri më 17.4.2018. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Raiffeisen Bank Durrës, datë 17.4.2018. Shuma: 9.156.833 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe dieta nga puna si Oficer Policie në Drejtorinë e Policisë Durrës, Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Mbikëqyrjes Policore, për periudhën 1.1.2018 deri më 7.3.2023. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Raiffeisen Bank Durrës, datë 7.3.2023. Shuma: 5.666.805 lekë.

- Të ardhura për mbulimin e disa vizitave studimore për shërbime policie, për vitin 2014, 2015 dhe 2016. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Raiffeisen Bank Durrës, datë 1.3.2023. Shuma: 3.239 euro.
- Të ardhura nga kapari për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 25.50 m², të ndodhur në Lagjen 13 Plazh, “Shkëmbi Kavajës”, Durrës, shitja e cila nuk u realizua, përfituar vlerën nga kapari 200.000 lekë. Sipas kontratës me kusht nr. *** rep., nr. 89 kol., datë 7.8.2013. Shuma: 200.000 lekë.

➤ ***Bashkëlidhur deklaratës***

- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshmë dhe pagën mesatare, ku vërtetohet se: për periudhën Janar 1992 – Prill 1993, Shkelqim Zuriqi ka realizuar të ardhura nga paga neto, me vlerë totale rreth **71.600 lekë**; ndërsa për periudhën para vitit 1991, nuk disponohet dokumentacion.
- ✓ Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku vërtetohet se: për periudhën 1.11.1994 – 30.4.2005, Shkelqim Zuriqi ka përfituar të ardhura neto në shumën totale **2.659.612 lekë**; për periudhën 1.5.1993 – 31.12.1993.
- ✓ Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 17.4.2018, ku vërtetohet se llogaria e Shkelqim Zuriqi, për periudhën 2005 – 2018, është kredituar në vlerën totale **9.156.833 lekë**.
- ✓ Statement bankar nga Raiffeisen Bank, printuar në datë 7.3.2023, për llogarinë në emër të Shkelqim Zuriqi, me balancë 5.589 Lekë, në datën 22.2.2023, ku rezulton kreditimi i të ardhurave për periudhën 1.1.2018 – 7.3.2023. Përmbledhje e veprimeve të kreditimit të llogarisë, për periudhën 11.1.2018 – 3.2.2023, me vlerë totale **5.666.805 lekë**.
- ✓ Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 17.4.2018, ku vërtetohet se llogaria e Shkelqim Zuriqi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, është kredituar në vlerën totale **3.239 euro**.
- ✓ Statement bankar nga Raiffeisen Bank, printuar në datën 1.3.2023, për llogarinë në emër të Shkelqim Zuriqi, me balancë 9 Euro, në datën 24.6.2016, ku rezulton kreditimi i shumës totale rreth 3.239 Euro, për periudhën 10.11.2014 – 20.6.2016.
- ✓ Kontratë shitblerje me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.2013, me shitës Shkelqim Zuriqi dhe blerës F. S, për shitjen e apartamentit nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, me adresë: Lagja nr. 13, Plazh Durrës, në vlerën sipas rivlerësimit prej 1.320.000 Lekë, nga të cilat shuma 200.000 Lekë është likuiduar dhe shuma prej 1.120.000 Lekë do të likuidohet në datën 20.1.2014 dhe në rast mosplotësimi të kushteve sa më sipër pagimi për shumën brenda afatit, shuma e likuiduar prej **200.000 lekë** nuk do të rikthehet dhe kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.

Hetimi administrativ:

34. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, konfirmon se në emër të Shkelqim Zuriqi, rezulton llogari page me balancë 10.072 lekë (overdraft me limit 120.000 lekë), si dhe llogari për tërheqje MasterCard, me balancë 0 lekë, në datë 10.03.2023. Referuar statementit

bankar, rezulton: kreditimi i llogarisë në vlerën totale rreth 14.825.000 lekë, për periudhën 17.5.2005 – 28.4.2023, nga të cilat të ardhurat nga paga, dietat, shpërblimet dhe kompesimi për veshje, për periudhën Maj 2005 – Mars 2023, në shumën totale rreth **14.552.000 lekë**.

35. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ***, datë 8.5.2023, konfirmon se në emër të Shkelqim Zuriqit, rezulton llogari rrjedhëse me balancë 9 euro, në datën 10.3.2023. Referuar statementit bankar, rezulton: kreditimi i shumës totale rreth 3.239 euro, për periudhën 10.11.2014 – 20.6.2016.

36. **ISSH**, me shkresë nr. ***, datë 10.5.2023, konfirmon se për Shkelqim Zuriqi, janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto:

- Nga subjekti “Drejtoria e Policisë së Qarkut”, për periudhën Janar 2012 – Korrik 2014;
- Nga subjekti “Drejtoria Përgjithshme e Policisë”, për muajn Qershor 2014;
- Nga subjekti “Drejtoria për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda”, për periudhën Korrik 2014 – Tetor 2014;
- Nga subjekti “Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale”, për periudhën Nëntor 2014 – Maj 2015;
- Nga subjekti “Drejtoria për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda”, për periudhën Qershor 2015 – Maj 2017;
- Nga subjekti “Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit”, për periudhën Maj 2017 – Shkurt 2018;
- Nga subjekti “Drejtoria e Policisë së Qarkut”, për periudhën Shkurt 2018 – Korrik 2018;
- Nga subjekti “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë”, për periudhën Maj 2018 – Dhjetor 2020;
- Nga subjekti “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, për periudhën Dhjetor 2020 – Shkurt 2022 si dhe;
- Nga subjekti “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore”, për periudhën Mars 2022 – Mars 2023.

✓ **Konfirmohet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara nga agjencitë ligjzbatuese dhe bankat e nivelit të dytë. Trupa e vlerësimit nga analizimi i llogarive bankare të subjektit për kreditimin e shumës totale rreth 3.239 euro, ka konstatuar se janë të kredituara nga OSCE, ku rezultojnë të ardhura për mbulim të vizave studimore për shërbime policie, përgjatë viteve 2014, 2015, 2016.**

A/3. SHPENZIMET E DEKLARUESHME

33. Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur – Periudha 1.1.2022 – 31.12.2022.

- Shpenzime për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për ujë të pijshëm sipas kontratës nr. *** me UKD. Shuma: 2.880 lekë.
- Shpenzime për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për energji elektrike sipas kontratës nr. *** me OSHEE. Shuma: 7.827 lekë.
- Shpenzime për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për energji elektrike sipas kontratës nr. *** me OSHEE. Shuma: 2.066 lekë.
- Shpenzime për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për televizion “TV Kabllor Shijaku”. Shuma: 19.200 lekë.
- Shpenzime për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për internet “TV Kabllor Shijaku”. Shuma: 10.800 lekë.
- Shpenzime për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për telefon me kompaninë celulare “Vodafone”. Shuma: 24.000 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Kopje e librezës së UKD, në emër të A. Z, sipas kontratës nr. ***. **B/lidhur:** Faturat tatimore për periudhën Janar – Dhjetor 2022, me vlerë totale 2.880 lekë.
- ✓ Kopje e librezës së OSHEE, në emër të A. Z, sipas kontratës nr. ***. **B/lidhur:** Mandatet e arkëtimit për periudhën Janar – Dhjetor 2022, me vlerë totale rreth 7.827 lekë.
- ✓ Kopje e librezës së OSHEE, në emër të Rexhep Zuriqi, sipas kontratës nr. ***. **B/lidhur:** Mandatet e arkëtimit për periudhën Janar – Dhjetor 2022, me vlerë totale rreth 2.066 lekë.
- ✓ Dokumentacion i vulosur nga “TV Kabllor Shijak”, ku vërtetohet se: për periudhën Janar – Dhjetor 2022, klienti Shkelqim Zuriqi ka paguar për shërbimit e televizionit, shumën totale rreth 19.200 lekë.
- ✓ Dokumentacion i vulosur nga “TV Kabllor Shijaku”, ku vërtetohet se: për periudhën Janar – Dhjetor 2022, klienti Shkelqim Zuriqi ka paguar për shërbimin e internetit, shumën totale rreth 10.800 lekë.

Hetimi administrativ:

34. **FSHU,** me shkresën nr.***prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
35. **15 Shoqëri Rajonale Ujësjellës – Kanalizime,** me shkresat nr. *** prot., datë 5.5.2023 deri më 17.7.2023, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
36. **Vodafone Albania sh.a,** me shkresat nr. ***prot., 13.6.2023, konfirmojnë se: në emër të Shkelqim Zuriqi rezultojnë katër numra telefonik për të cilët janë paguar detyrimet në vlerë totale rreth 22.741 lekë, për vitin 2022, si dhe në emër të M. Zuriqi (bashkëshortja e subjektit)

rezulton një numër telefonik për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 9.441 Lekë, për vitin 2022.

37. One Albania sh.a. nëpërmjet postës elektronike të datës 31.7.2023, konfirmon se në emër të Shkelqim Zuriqi, rezultojnë të regjistruar dy numra telefonik celular, për të cilët **nuk është kryer rimbushje gjatë periudhës 1.1.2022 – 31.12.2022.**

38. Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2023, konfirmon se Shkelqim Zuriqi, ka një kontratë të nënshkruar në datën 16.6.2021, për shërbim interneti. Bashkëlidhur:

- Formular për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit, datë 16.6.2021, me klient Shkelqim Zuriqi, për shërbim interneti familjar në adresë: Lagjia “Kodër”, me afat 24 muaj dhe pagesë 900 lekë/muaj.
- Faturë tatimore datë 15.1.2022, me blerës Shkelqim Zuriqi dhe shitës Albanian Satellite Communications sh.p.k, për shërbimin e internetit me vlerë 5.400 lekë.
- Faturë tatimore datë 24.12.2022, me blerës Shkelqim Zuriqi dhe shitës Albanian Satellite Communications sh.p.k, për shërbimin e internetit me vlerë 5.400 Lekë.
- Abissnet sh.a, me shkresën nr. V – prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur, për periudhën 1.1.2022 – 31.12.2022.
- Digicom sh.a. me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur, për periudhën 1.1.2022 – 31.12.2022.

→**Në proces – verbalin e datës 20.6.2023,** të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar sipas deklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur duke sqaruar se:

*“...Për apartamentin në plazh, me sipërfaqe 25.5 m², kontrata e furnizimit me ujë, me nr. *** dhe kontrata e furnizimit me energji elektrike, me nr. ***, janë lidhur nga vëllai A. Z dhe nuk janë ndryshuar ndër vite, pasi apartamenti është përdorur për periudha të limituara kohore nga familjarët, duke sqaruar se gjeneralitetet e shënuara të vëllait konkretisht emri në kontratën e furnizimit me energji elektrike, mund të jenë gabime materiale.*

*Gjithashtu, subjekti sqaroi se kontratat e furnizimit me energji elektrike për garazh me sip. 51 m², me nr. ***, është lidhur nga babai im Rexhep Zuriqi dhe nuk është ndryshuar ndër vite, për shkak të përdorimit të ambientit nga babai para ndarjes nga jeta, duke saktësuar se furnizimi me energji elektrike dhe ujë, i banesës me sipërfaqe 139 m², ka qenë në ngarkim të familjes, duke u paguar nga nëna ime Sh. Z dhe për këtë arsye shpenzimet nuk janë evidentuar. Subjekti ka konfirmuar shpenzimet për televizion dhe internet, sipas deklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur, duke sqaruar se nuk disponon kontrata të tjera të ngjashme. Gjithashtu subjekti ka konfirmuar shpenzimet me vlerë 500 lekë/muaj për vitin 2022, për secilin nga katër numrat Vodafone të cilët disponon...”.*

→**Në proces – verbalin e datës 27.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se:

“Për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare, kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike nuk janë saktësuar apo ndryshuar, pavarësisht pronësisë së aseteve, si dhe ka sqaruar se shpenzimet janë deklaruar me përfaqësi, sipas përllogaritjeve. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar sipas korrespondencës së Vodafone sh.a., dhe ka sqaruar se shpenzimet e bashkëshortes nuk janë evidentuar në formular, për shkak të llogaritjes së shpenzimeve vetëm për numrat e disponuar në emrin e tij, duke saktësuar se këto shpenzime rezultojnë me vlerë relativisht minimale, të regjistruara elektronikisht dhe lehtësisht të verifikueshme”.

→**Në inventarin nr. extra.port., datë 27.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka dorëzuar:

- ✓ Certifikatë familjare, sipas regjistrimit themeltar 1974 – 2009, kryefamiljar Rexhep Zuriqi, dhe dy nga anëtarët e trungut: Shkelqim Zuriqi (i biri) dhe A. Z (i biri).
- ✓ Shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur për ujë, drita, telefon dhe internet, gjatë periudhës 1.1.2022 – 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 75.000 Lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e Albanian Satellite Communications sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a.**

A/4. Për udhëtimet privatë, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përbaluara – Periudha 1.1.2020 - 31.12.2022.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- Udhëtim për trajnim në Budapest, Hungari, për periudhën 29.5.2022 deri 6.5.2022, me shpenzime të mbuluara nga AMP. Shuma: 0 lekë.
- Udhëtim për nevoja puna dhe shërbimi, në Prizren, Kosovë, për periudhën 20.4.2022 deri më 20.4.2022, me shpenzime të mbuluara nga AMP. Shuma: 0 lekë.
- Shpenzime udhëtimi për vizitë private në Prizren, Kosovë, për periudhën 13.12.2021 deri më 13.12.2021. Shuma: 20 euro.
- **Bashkëlidhur deklaratës:**
 - ✓ Printim i kërimit nga sistemi *****, ku vërtetohet se shtetasi Shkelqim Zuriqi, ka udhëtuar në dalje nga Aeroporti i Rinasit, në datën 5.6.2022.
 - ✓ Printimi i kërimit nga sistemi *****, ku vërtetohet se shtetasi Shkelqim Zuriqi ka udhëtuar në dalje nga Pika Kufitare Morinë, me automjetin AA***UN, në datën 20.4.2022, dhe ka

udhëtuar në hyrje nga Pika Kufitare Morinë, me automjetin me targë AA***UN, në datën 20.4.2022.

- ✓ Printim i kërimit nga sistemi ****, ku vërtetohet se shtetasi Shkelqim Zuriqi ka udhëtuar në dalje nga Pika Kufitare Morinë, me automjetin me targë AB***CB, në datën 13.12.2021 dhe ka udhëtuar në hyrje nga Pika Kufitare Morinë, me automjetin me targë AB***CB, në datë 13.12.2021.

→**Ne proces – verbalin e datës 27.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se ka udhëtuar me automjetin me targë AB***CB, në datën 13.12.2021.

→Në inventarin nr. extra prot., datë 27.6.2023, subjekti ka dorëzuar:

→Raportin nga sistemi ****, lidhur me automjetin me targë AB***CB, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Morinë, në datën 13.12.2021.

→**Në proces – verbalin e datës 30.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar se personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të kenë udhëtuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gjatë tre viteve të fundit.

→**Nëpërmjet postës elektronike të datës 4.7.2023, subjekti ka dorëzuar:**

→Printim i kërimit nga sistemi ****, datë 4.7.2023, ku vërtetohet se bashkëshortja M. Zuriqi, fëmijët M. Z dhe O. Z, nuk kanë kryer hyrje apo dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, për periudhën 1.1.2020 – 31.12.2022.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Nga këqyrja e sistemeve të Policisë së Shtetit, konkretisht të hyrje – daljeve, ka rezultuar se subjekti i vlerësimit ka realizuar vetëm 1 (një) hyrje – dalje 1 (një) ditore në drejtim të Kosovës, për vizite personale dhe 2 (dy) hyrje – dalje për trajnime/shërbime për nevoja puna. Trupa e Vlerësimit pas verifikimit të kryer dhe korrespondencës së administruar me institucionet ligjzbatuese dhe ato të drejtësisë ka konstatuar se, subjekti i vlerësimit Z. Shkelqim Zuriqi nuk ka kontakte me persona të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krim të organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 35 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e dhëna dhe dokumentacionin e dorëzuar, sa i përket hyrje daljeve nga R. SH, të subjektit dhe personave të lidhur, gjatë periudhës 1.12.2020 – 31.12.2022.**

- ✓ Shpenzimet e deklaruara për udhëtime private të subjektit, gjatë periudhës 1.1.2020 – 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 20 euro, e konvertuar rreth 2.300 lekë.
- ✚ Për arsimin e fëmijëve madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik – Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- Shpenzime për arsimimin e djalit O. Z, në shkollën 9 – vjecare jopublike “*****” Durrës, për periudhën 2018 – 2022. Shuma: 284.000 lekë.
- Shpenzime për arsimimin e djalit, O. Z, në shkollën 9 – vjecare dhe të Mesme jopublike “*****”, Durrës, për periudhën 2022 – 2023. Shuma: 60.000 lekë.
- Shpenzime për arsimimin e djalit, M. Z, në shkollën 9 – vjecare jopublike “*****”, Durrës, për periudhën 2018 – 2023. Shuma: 339.000 lekë.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Vërtetim nga shkolla jopublike “*****”, Durrës, nr. 2884 prot., datë 4.3.2023, ku vërtetohet se për nxënësin O. Z, për periudhën 2018 – 2022, janë paguar nga familjarët shumat me vlerë totale 284.000 lekë; nga të cilat: shuma 67.000 lekë për vitin shkollor 2018 – 2019, shuma 69.000 lekë për vitin shkollor 2019 – 2020, shuma 71.000 Lekë për vitin shkollor 2020 – 2021 dhe shuma 77.000 lekë për vitin shkollor 2021 – 2022.
- ✓ Vërtetim nga shkolla 9 – vjecare dhe e mesme jopublike “*****”, Durrës, nr. 1042 prot., datë 6.3.2023, ku vërtetohet se O. Z është nxënës pranë shkollës së mesme, sipas kontratës me vlerë totale 95.000 lekë/viti, për vitin shkollor 2022 – 2023.
- ✓ Vërtetim nga shkolla jopublike “*****”, Durrës, nr. 2884 prot., datë 4.3.2023, ku vërtetohet se për M. Z, për periudhën 2018 – 2023, janë paguar nga familjarët shumat me vlerë totale 339.000 lekë, nga të cilat; shuma 67.000 lekë për vitin shkollor 2018 – 2019, shuma 69.000 lekë, për vitin shkollor 2019 – 2020, shuma 71.000 lekë për vitin shkollor 2020 – 2021, shuma 77.000 lekë për vitin shkollor 2021 – 2022 dhe shuma 55.000 lekë për vitin shkollor 2022 – 2023.

Hetimi administrativ:

- 39. **Instesa Sanpaolo Bank,** me shkresën nr. ***, datë 12.5.2023, konfirmon se rreth 212.000 lekë, të depozituar cash për periudhën 27.3.2019 – 13.1.2023, për shkollimin e O. Z dhe M. Z.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank, Shkolla jopublike “****”, Durrës dhe shkolla jopublike “****”, Durrës.**
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për arsimin e fëmijëve, gjatë periudhës deri më datën 10.3.2023, rezultojnë në total rreth 683.000 lekë.**

A/5. DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – M. ZURIQI

DEKLARIMI I PASURIVE.

Pasuria Nr. 1

Tokë arë më sipërfaqe 12.101 m², e ndodhur në Sukth, Durrës. Akti i marrjes se tokës në pronësi nr. ***, datë 31.10.1992. Pasuria nr. ***, zona kadastrale ***, sipas certifikatës së pronësisë, datë 28.5.2007. **Burimi i krijimit:** përfutur sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. Vlera 0 Lekë. Pjesa takuese 12.5 %.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës**

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 28.5.2007, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit arë më sipërfaqe 12.301 m², e ndodhur në Borakë, Durrës, regjistruar në pronësi të familjes bujqësore, në emër të A. G (vjehtëri i subjektit).
- ✓ Akti i marrjes së tokës në Pronësi, nr. ***, datë 31.10.1992, ku vërtetohet se sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, familjes së A. G, nga fshati Borakë- Durrës, i jepet në pronësi tokë me sipërfaqe 16.551 m², konkretisht: 4450 m², me nr. ***, nga e cila 4.200 m² arë dhe 250 m² truall; dhe 12.101 m² e llojit arë me nr. ***.

PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

ASHK (online), konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, regjistruar në pronësi të A. G, me status “aktive”.

→ **Në Proces-verbalin e datës 27.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

- Subjekti ka sqaruar se deklarimi i pasurisë është kryer mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar duke saktësuar se nuk janë kryer matjet fizike në terren dhe nuk është e qartë sipërfaqja reale e disponuar. Gjithashtu ka sqaruar se nuk kanë asnjë kontribut familjar në krijimin e pasurisë, si dhe nuk përfitojnë të ardhura nga toka e llojit arë.

→ **Në Proces-verbalin e datës 27.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dorëzuar:

- ✓ Certifikatën e trungut familjar të vitit 1991, me kryefamiljar A. G dhe anëtarë K. G (bashkëshortja), H. G (i biri), F. G (e bija), N. G (e bija), L. G (i biri) dhe M. G (e bija).
- ✓ Certifikatë martesë datë 22.6.2023, me bashkëshort Shkelqim Rexhep Zuriqi dhe bashkëshorte M. G, me datë lidhje të martesës 9.8.2004.

40. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

Pasuria arë me sipërfaqe 12.101 m², në Sukth, Durrës, e përfituar nga familja e bashkëshortes me kryefamiljar A. G, referuar AMTP të vitit 1992, është deklaruar sipas dokumentacionit të dorëzuar duke saktësuar, se për pjesën takuese të pandarë 12.5% të bashkëshortes, si anëtare e familjes bujqësore, nuk kanë asnjë kontribut financiar për krijimin e pasurisë, si dhe nuk përfitojnë të ardhura.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

A/6. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga dhe shpërblime, nga puna në ndërrmarjen CONFEZIONE MAR shpk, për periudhën nga data 1.1.1999 deri më 31.1.2007. sipas vërtetimit nga Instituti i Sigurime Shoqërore. Shuma: 1.096.542 lekë.
- Të ardhura nga leja e lindjes së djalit, O. Zuriqi, për periudhën Maj 2007 – Maj 2008, si dhe asistencë për periudhën Maj 2008 – Maj 2009. Shuma: 123.000 lekë.
- Të ardhura si kujdestare paraplegjik, për periudhën nga data 1.1.2014 deri më datë 31.1.2023. sipas vërtetimit nga Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore, Bashkia Shijak, me nr. ***, datë 5.3.2023. shuma: 1.183.541 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme, ku vërtetohet se nga punëdhënësi CONFEZIONE MAR shpk, për periudhën Janar 1999 – Janar 2007, për të siguruarin M. G (Zuriqi), është paguar kontribut mbi bazën e të ardhurave nga paga me vlerë totale rreth 1.116.500 lekë, si dhe për periudhën Shkurt – Prill 2007, është trajtuar me raport.
- ✓ Vërtetim nga ISSH, Dega e Arkivit Durrës, me nr. 25 prot., datë 7.3.2023, ku vërtetohet se subjekti “Kujdestari Paraplegjik” ka paguar kontribut shoqëror për shtetasen M. G (Zuriqi), për periudhën 1.3.2014 – 31.12.2022.

- ✓ Vërtetim nga Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore në Bashkinë Shijak, me nr. 1419., ku vërtetohet se Sh. Z (nëna e subjektit), trajtohet me status Paratraplegjik me kujdestar M. Zyriqi dhe pagesat për kujdestaren, për periudhën Janar 2014 – Janar 2023, janë në shumën totale të përlloritur rreth 1.183.500 lekë.

Hetimi administrativ.

- ✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. 33/5, datë 12.5.2023, konfirmon se M. Zuriqi ka patur llogari rrjedhëse aktive, për periudhën 2014 – 2018. Referuar statementit bankar, rezulton: kreditimi i të ardhurave nga paga për kujdestar paraplegjik, për periudhën 29.8.2014 – 4.3.2016, me shumën totale rreth 252.480 lekë.

→**Në Proce-verbalin e datës 20.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me të ardhurat dhe saktësimin e gjeneralitetve të bashkëshortes dhe nënës së subjektit, ka deklaruar:

*“Subjekti ka konfirmuar të ardhurat sipas dokumentacionit të paraqitur, si dhe ka sqaruar se gjeneralitetet (mbiemri) në Vërtetimin nr.*** prot., të Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe i Shërbimeve Shoqërore, Bashkia Durrës, mund të jenë rrjedhojë e gabimit material. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja, për lejen e lindjes dhe asistencën sociale.*

→**Në Proce-verbalin e datës 27.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se të ardhurat e bashkëshortes për periudhën Maj 2007 – Maj 2009, janë përlloritur dhe deklaruar me përafërsi.

→Në inventarin nr. extra prot., datë 27.6.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim nga DRSSH, për periudhën 21.4.2007 – 19.4.2008, ku vërtetohet se M. Zuriqi ka përfituar të ardhura nga ditët me raport, në shumën rreth 109.100 lekë.
- Vërtetim për pagesën e papunësisë për periudhën Prill 2008 – Prill 2009, ku vërtetohet se M. Zuriqi ka përfituar të ardhura, në shumën totale rreth 77.700 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar nga institucionet ligjzbatuese dhe përgjigjen e Tirana Bank.**

- ✚ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti i vlerësimit Shkelqim Zuriqi ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile: “****”, Nd. **, H. **, Rrashbull, Durrës”, si dhe adresën ku banon: “Lagjia Kodra, Shijak, Durrës, Shqipëri”.

- **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Certifikatë personale datë 20.2.2023, për Shkelqim Zuriqi, i datëlindjes 24.1.1966 me vendbanim “***** Nd. **, H. **, Rrashbull, Shkallnur, 2021 Durrës”.

→ **Në Proce-verbalin e datës 20.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me adresën e sipërcituar, konkretisht:

“Adresa e banimit sipas Gjendjes Civile i përket shtëpisë së plazhit, të deklaturar me sipërfaqe 25.5 m², dhe adresa e banimit i përket shtëpisë trashëguar, me pjesë takuese 1/10, të deklaruar me sipërfaqe 139 m²”.

- ✓ *Adresa e regjistrimit në gjendjen civile i përket pasurisë së llojit apartament me sip. 25.2 m², të trajtuar më sipër; ndërsa adresa e banimit i përket pasurisë së llojit banesë 1 – kat, me sipërfaqe 139 m², të trajtuar më sipër.*

41. Banka e Shqipërisë, Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Pro Credit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Credins Bank, Union Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, EasyPay, Fondi Besa, Iutecredit, Kredo Financ, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarinimin.

42. Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Zonat e Stimuluara; **Librazhd; Krujë; Devoll; Korçë, Berat; Fier; Pogradec; Gjirokastrë; Mallakastër; Tirana Rurale 1; Tiranë Jug; Kamëz Vorë; Gramsh; Lushnjë; Kavajë; Kuçovë; Malësi e Madhe; Elbasan; Kolonjë; Has; Pukë; Peqin; Skrapar; Kukës; Tropojë; Bulqizë; Tiranë Veri; Tepelenë; Mirditë; Përmet; Tiranë Rurale 2; Mat; Sarandë; Shkodër; Kurbin; Dibër; Vlorë; Lezhë**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

43. Union Financiar Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kanë kryer veprime si klientë.

44. AK – Invest sh.a., me shkresën nr. *** prot, datë 10.5.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kanë kryer transaksione si klientë. Referuar CD, rezultojnë: 8 transaksione të kryera nëpërmjet MoneyGram, me vlerë totale rreth 4.023 euro (nga të cilat në total rreth 182 euro pagesë shërbimi), për periudhën 4.2.2015 – 10.12.2015, me dërgues M. G (Itali) dhe marrës M. Zuriqi (Shqipëri).

→ **Në lidhje me transaksionin e kryer është pyetur subjekti Shkelqim Zuriqi i cili në proces-verbalin e mbajtur më datë 18.7.2023, ka konfirmuar sa më sipër dhe ka sqaruar se: M. G është bashkëshortja e L. G (vëllai i bashkëshortes së tij M. G), duke saktësuar se shumat e transferuara kanë si burim financiar punën familjare të L. G dhe M. G, si emigrantë në Itali dhe si destinacion**

pagesën për punimet që po kryeheshin në banesën e tyre në Shijak, pagesa të cilat në pamundësi për ti kryer fizikisht, janë kryer sipas dërgesave nga bashkëshortja e tij M. Zuriqi dhe për të cilat, për shkak të distancës kohore dhe mospasjes së interesave pasurore, nuk disponon dokumentacion justifikues.

✓ Për të vërtetuar marrëdhënien familjare motër – vëlla, Trupa e Vlerësimit ka administruar, certifikatën e trungut familjar të vitit 1991, ku vërtetohet kjo marrëdhënie.

45. QKB, me shkresën nr. ***, prot, datë 8.5.2023, konfirmon se subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur, nuk konfirmojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrit tregtar.

46. D. P. Tatimeve, me shkresën nr. V-prot., datë 11.5.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

47. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ***, datë 10.5.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.

48. Nëpërmjet hetimit të zhvilluar kryesisht Trupa e Vlerësimit, në zbatim të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, me shkresë nr.*** prot., datë 11.9.2023, kërkoi nga Regjistri Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë informacion në lidhje me aktet e kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të nga ku në kthim përgjigje nr.*** prot, datë 15.09.2023 u konstatua se: nga Regjistri Noterial Shqiptar, nga Notere I. G:

1. Prokurë e Posaçme, Nr. Rep. ***, Nr. Kol ***, datë 19.8.2020.

Trupa e Vlerësimit në shterim të faktit të dalë nga kthim-përgjigje e mësipërme ju drejtua me shkresë zyrës së notërisë I. G, ku janë kryer aktet e mësipërm dhe me kthim përgjigje nr.prot, datë 6.10.2023, rezulton se figurojnë veprime juridike të tjera, konkretisht:

- Prokurë e Posaçme, Nr. rep.***, Nr. kol ***, datë 19.8.2020, banorët (përfshirë subjektin e vlerësimit Shkelqim Zuriqi) e një objekt banimi 5 - kat, Nr. 8, Rruga “Naim Frashëri Shijak”, në Zonën kadastrale ***, ndodhur në Bashkia Shijak, kanë autorizuar përfaqësues, për të kryer veprime juridike në emër dhe përlllogari të banorëve të pallatit Nr. 8, për riparime/rikonstrukcion të pallatit të dëmtuar nga tërmeti.

Trupa e vlerësimit, referuar faktit të sipërcituar, ka kryer hetime pranë ASHK Durrës, e cila me shkresën nr.***prot, datë 22.11.2023, ka rezultuar se, për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të, pas verifikimit në sistemin multifunksional ka konfirmuar pasuritë e sipërcituara dhe të deklaruara nga vet subjekti i vlerësimit.

Në kuadër të kryqëzimit të informacionit, trupa e vlerësimit i është drejtuar subjektit nëpërmjet postës elektronike, për informacion objekt banimi 5 - kat, Nr. 8, Rruga “Naim Frashëri Shijak”, në Zonën kadastrale ****, ndodhur në Bashkia Shijak.

❖ Në kthim përgjigje, subjekti ka sqaruar se:

*“Kjo pasuri ndodhet në katin e parë të një pallati objekti banimi 5 - kat, Nr. 8, Rruga “Naim Frashëri Shijak”, në Zonën kadastrale ***, ndodhur në Bashkia Shijak.*

*Unë Shkelqim Zuriqi, në cilësinë e një prej bashkpronarëve të pasurisë “Njësi” me sipërfaqe 38.2 m², ndodhur në Lagjen “Kodra” Shijak, Durrës. Numri pasurisë **** e cila siç e thashë edhe mësipër ndodhet në katin e parë të këtij pallati, së bashku me banorët e tjerë të pallatit nëpërmjet Prokurës së Posaçme të mbajtur më datë 19.8.2020, kemi autorizuar një përfaqësues për të kryer veprime juridike në emër dhe përlllogari të banorëve të pallatit Nr. 8, për riparime/rikonstruksion të pallatit të dëmtuar nga tërmeti të vitit 2019.*

*Dokumentacionin për pasurinë “Njësi” me sipërfaqe 38.2 m², ndodhur në Lagjen “Kodra” Shijak, Durrës. Numri pasurisë ***, e gjeni bashklidhur “Deklaratë e pasurisë për vlerësimin kalimtar” të dorëzuar”.*

✓ **Pasuria e përmendur nga subjekti është e trajtuar mësipër.**

49. Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktoritetit u mbështetet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

50. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramëve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklaramëve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

51. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

52. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Shkelqim Zuriqi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:

- ✓ Deklaratën e “*Kontrollit të Figurës*”;
- ✓ Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- ✓ Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

53. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42 pika 1, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport për subjektin e vlerësimit, me nr. *** Prot, datë 23.8.2023, i përpiluar me përgjigjet e organeve ligjzbatuese dhe institucioneve shtetërore, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit Shkelqim Zuriqi.

🚩 Në deklaratën “*Kontrolli i Figurës*”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale

- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk është caktuar ndaj tij ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë ndaj tij asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së Subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitetet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish - shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Hetimi administrativ.

54. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin

kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligjzbatuese, ka rezultuar si vijon:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 25.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:
 - Shtetasi Shkelqim Zuriqi, ka lindur në ZGJC Shijak-Durrës, më 24.01.1966, në bazë të Aktit nr.***, datë 28.05.1966, me të dhënat; atësia Rexhep; amësia Sh. dhe mbiemër Zyba.

Me Vendim nr. 20, datë 23.05.1975, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, kanë ndryshuar mbiemrin familjarisht nga “Zuba” në “Zuriqi”.

Nga verifikimet e kryera, nuk rezulton të këtë kryer ndryshime të tjera të gjeneraliteteve, ose lënie/marrje shtetësie.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:

***Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

“Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë”.

- Nga verifikimi i kryer nga DPGJC, rezulton se subjekti i vlerësimit Shkelqim Zuriqi, ka ndryshuar gjeneralitet konkretisht mbiemrin.
 - **Nga korrespondenca me email me subjektin e vlerësimit Shkelqim Zuriqi, është pyetur në lidhje me këtë fakt, i cili në kthim përgjigje me shkresë Nr. *** prot, datë 2.10.2023, ka dhënë shpjegimet si më poshtë:**

“Lidhur me faktin, sipas ZGJC Shijak – Durrës, ku rezulton se unë nga koha e lindjes, më datë 24.1.1966, kam pasur mbiemrin “Zyba” dhe këtë mbiemër e kam mbajtur deri më datë 23.5.1975, ku pas kësaj date e deri aktualisht ka ndryshuar mbiemri nga “Zyba” në “Zuriqi” (për rreth nëntë vjet dhe në një moshë shumë të vogël), dua të them se për këtë fakt jam vënë në dijeni vetëm nëpërmjet email-it të dërguar nga ana Juaj. Nuk kam pasur dijeni më parë.

Çdo dokument që kam marrë nga institucionet shtetërore apo kam aksesuar vetë (certifikatë lindje, familjare, martese, deftesa, diploma etj) kanë qenë me mbiemer “Zuriqi.

Siç e thash dhe mësipër, arsyeja e mos deklaramit në Deklaratën për Kontrollin e Figurës për Vlerësimin Kalimtar, është mos pasja dijeni e këtij fakti”.

Në bazë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Trupa e Vlerësimit konstatoi se:

***Në lidhje me ndryshimin e mbiemrit të familjes së subjektit të vlerësimit Shkelqim Zuriqi, kryer në vitin 1975, në atë periudhë kohe rezulton që subjekti të ketë qënë rreth moshës 9 vjeç dhe që nga viti 1975 e deri më sot bëhen rreth 48 vite më parë. Si dhe mungesës së plotë të zotësisë juridike për të kryer veprime juridike për periudhën para vitit 1975 nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ndryshimin e gjeneraliteteve nga ana e subjektit të vlerësimit sipas legjislacionit në fuqi të kohës.

Për këtë arsye vlerësojmë se, mospasqyrimi i ndryshimit të mbiemrit në formularin e Kontrollit të Figurës nga subjekti i vlerësimit, nuk kategorizohet tek përcaktimet e nenit 42, pika 3, gërma “a” e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

- **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 19.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:
 - **Nuk rezulton i dënuar.**
- **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 30.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - **Nuk kanë** të dhëna/informacione të vërtetuara që janë të përfshirë ose të dyshuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar.
 - **Nuk kanë** të dhëna/informacione për kontakte të papërshtatshme.
 - **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.
- **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 26.5.2023, dhe shkresën “E paklasifikuar”, me Nr. ***, datë 30.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare:
 - **Nuk ka** të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime të ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar*, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe

funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;

- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);
 - **Nuk ka** të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
 - **Nuk ka** të dhëna nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - **Nuk ka** të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - **Nuk ka** të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - **Nuk ka** të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO;
 - **Nuk ka** të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
 - **Nuk ka** procedim disiplinor apo masë disiplinore.
- **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 31.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:
 - **Nuk disponon të dhëna.**
 - **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret”, e datës 13.6.2023, shkresën “Sekret”, Nr. ***, datë 19.6.2023, dhe shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 25.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - **Nuk kanë** të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
 - **Nuk ka** procedime penale të referuara;
 - Për subjektin e vlerësimit, **nuk administrohen ankesa**, të dhëna ose informacione që lidhjen me objektin e kërkesës.

- **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 27.6.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:
 - **Nuk është** nxjerrë urdhër ndalimi;
 - **Nuk është** kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - **Nuk është** marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - **Nuk ka pasur** regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - **Nuk ka pasur** raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 1.6.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi:
 - **Nuk rezulton** të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
- **Institucion ligjbatues**, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 19.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - **Nuk rezultuan raportime** për subjektin e vlerësimit Shkelqim Zuriqi dhe personat e lidhur me të M. Zuriqi, O. Zuriqi dhe M. Zuriqi.
- **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 19.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:
 - Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me Nr. CSP ****, me datë lëshimi 22.10.2020, të vlefshme deri më datë 21.10.2025.
 - Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
 - Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- **Avokati i Popullit**, me shkresën “I Paklasifikuar”, Nr. *** Prot, datë 30.5.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
- **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 8.6.2023, për subjektin e vlerësimit Z.Shkelqim Rexhep Zuriqi, bën me dije se:
 - **Nuk ka qenë** në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z.Shkelqim Rexhep Zuriqi **nuk është disponuar asnjë ankese** nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z. Shkelqim Zuriqi:**

- **Nuk rezulton** përdorues i lëndëve narkotike.

55. Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës: Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Shkelqim Zuriqi, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figures, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Shkelqim Rexhep Zuriqi:

- ***Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***

- *Nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

56. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

57. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- b. raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

58. Subjekti i vlerësimit **Z. Shkelqim Zuriqi** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të Ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5 – vjeçare (2018 – 2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shtrihet brenda këtij harku kohor.

59. **Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore,** është struktura përgjegjëse për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport i hollësishëm për subjektin e vlerësimit, me nr. *** Prot, datë 21.07.2023, i përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale, në të cilin është konstatuar se:

- **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.**
- **Ka vlerësime pozitive pune.**

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:

- Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Shkelqim Zuriqi Urdhër Nr. 2123, datë 14.12.2020, është emëruar Drejtor i Analizës dhe Kartotekës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë e Mbikëqyrjes Policore.
 - Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Shkelqim Zuriqi e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.
60. Subjekti i vlerësimit ka plotësuar formularin e aftësive profesionale në funksionin e Drejtor i Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Subjekti është emëruar në këtë funksion me Urdhër Nr. 2123, datë 14.12.2020. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Subjekti i vlerësimit Shkelqim Zuriqi, nga viti 2018 – 2020, ka qenë pjesë e strukturës së Policisë së Shtetit dhe nga viti 2020 e aktualisht me funksion Drejtor i Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së.

C/1. Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron të dhëna për arsimimin:

- Arsime policore Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme viti 1984 – 1988.
- Arsime të Lartë Juridike – 1993 – 2002.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit për të vërtetuar saktësinë e deklaramit të subjektit, i është drejtuar institucionit publik të mëposhtëm:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, me shkresën nr. ***, datë 14.6.2023, ka konfirmuar se:

- Z. Shkelqim Zuriqi, ka filluar studimet pranë Shkollës së Lartë të M.P.B (me shkëputje nga puna), në vitin 1984, Dega Polici, me Nr. Amze 1263, përfunduar në vitin 1988.
- Në periudhën 14.1.2019 deri më 28.1.2019, ka kryer trajnim me temë: Për ngritjen në gradën “*K/Komisar*”.

Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
DND	Shkolla e lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dega Polici.	1984	1988	Tiranë	Diplomë
DND	Fakulteti i Drejtësisë, Universitetin e Tiranës, dega “Drejtësi”,	1991	2002	Tiranë	Diplomë
Dëshmi e Gjuhës së Huaj	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	2003	2003	Tiranë	Dëshmi e gjuhës Serbo – Kroate.

- ✓ *Në kuptim të legjislacionit ndër vite për Policinë e Shtetit dhe në Ligjin në fuqi 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (i ndryshuar), trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se për subjektin e vlerësimit, ecuria në karrierë ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe/apo ushtron.*
- ✓ *Trupa e vlerësimit konkludon se niveli arsimor është në përputhje me ushtrimin e detyrës.*

C/2. Masat Disiplinore:

Nga verifikimi në dosjen e personelit si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare referuar nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar **subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.**

- ✓ *Trupa e vlerësimit konstaton se subjekti i vlerësimit përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.*

C/3. Vlerësimet e punës:

Bazuar në nenin 45, pika 2, shkronja (Ç), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë dhe vlerësimet e punës.

Në dosjen e personelit të subjektit gjenden vlerësimet e performancës për vitet 2018 - 2022. Bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton

se subjekti është vlerësuar përgjithësisht në të pesta vitet me pikët maksimale për punën e kryer si më poshtë:

- ✓ Vlerësimi i rezultateve individuale të punës për vitin 2018, periudha e vlerësimit (01/01/2018- 31/12/2018) është vlerësuar me 28 pikë nga 28 pikë.
- ✓ Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2019 - 31/12/2019 është 28 pikë nga 28 pikë.
- ✓ Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2020 - 31/12/2020 është vlerësuar më “Shumë mirë”.
- ✓ Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2021 - 31/12/2021 është vlerësuar më “Shumë mirë”.
- ✓ Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2022 - 31/12/2022 është vlerësuar më “Shumë mirë”.

Në vlerësimet e eprorëve thuhet ndër të tjera se:

- ✓ Zotëron aftësi të mira profesionale dhe hartimin e projekteve cilësore.
- ✓ Njeh dhe zbaton shumë mirë aktet ligjore dhe nënligjore.
- ✓ Aktiv në grupe pune, kryesisht në implementimin e sistemeve por edhe të draft akteve ligjore dhe nënligjore.
- ✓ Ka figurë të pastër morale në kryerjen e detyrave.

C/4. Të dhëna për Kualifikimet Profesionale, Trajnimet, Konferencat Shkencore.

Në pikën 3, të formularit të aftësive profesionale, subjekti përgjatë viteve deklaron pjesëmarrjen në konferenca brenda dhe jashtë vendit, kurse trajnimi brenda dhe jashtë vendit duke cituar edhe çertifikatat përkatëse të marra lidhur me këto veprimtari.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Për të vërtetuar saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramit të subjektit janë kërkuar të dhëna nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore si dhe me korrespondencën me vetë subjektin. Në dosjen e personelit dërguar nga kjo drejtori, si vetë subjekti ka konfirmuar të gjitha trajnimet e përmendura të cilat i shoqëron me dëshmitë apo çertifikatat të kryera nga subjekti, konkretisht:

- Trajnim me temë: Trajnim për “Programin e formimit të trajnuesve për kursin e hetimit të krimin, Niveli 1”, viti 2023.
- Trajnim me temë: Trajnim për “Hetim Korrupsioni”, ILEA, viti 2022.
- Trajnim me temë: Trajnim për “iBase”, niveli “user”, nga IBM, viti 2021.
- Trajnim me temë: Trajnim për “iBase”, niveli “disagner”, nga IBM, viti 2021.
- Trajnim me temë: Trajnim për “i2 Analyst Notebook”, nga IBM, viti 2021.

- Trajnim me temë: “Training Program on Crime Intelligence Analysis”, Turkish National Police, viti 2019.
 - Certifikatë për fitim gradës “Kryekomisar”, Akademia e Sigurisë, viti 2019.
 - Trajnim me temë: Trajnim “Criminal Intelligence Database and IT Structures Supporting Intelligence – Led Policing, OSCE, Skopje, North Macedonia, viti 2019, etj.
- ✓ **Për sa më lart, trupa e vlerësimit, konkludon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga hetimi dhe se kualifikimet dhe trainimet e vazhdueshme kanë rritur aftësinë profesionale në ushtrimin e detyrës.**

C/5. Ecuaria në karrier.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Subjekti i vlerësimit Shkelqim Rexhep Zuriqi, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 32 vite dhe rreth 3 vite pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Nga verifikimi në dosje personale rezultojnë se gjatë periudhës 5-vjecare objekt deklarimi, subjekti ka ecuar në karrierë si vijon:

- Urdhër nr. 1095, datë 5.05.2017, është emëruar Shef Stacioni në Stacionin e Policisë Kufitare, Porti-Durrës, për periudhën 01.06.2017-20.02.2018;
 - Urdhër nr. 274/1, datë 16.02.2018, është emëruar Shef Sektori për Krimet në D.V.P Durrës për periudhën 01.06.2017-20.02.2018;
 - Urdhër nr. 274/3, datë 02.05.2018, është emëruar Specialist/Analist cilësia e informacionit, në DPPSH-së, për periudhën 05.05.2018-14.12.2020;
 - Urdhër nr. 1691, datë 15.12.2020, për lirim nga policia të një punonjësi policie.
 - Urdhër Nr. 2123, datë 14.12.2020, është emëruar Drejtor i Analizës dhe Kartotekës, në Drejtorinë e Përgjithshme të SHÇBA-së.
- ✓ **Nga kontrolli dhe verifikimi rezultojnë se emërimet dhe ngritjet në gradë janë bërë në përputhje me kërkesat e Ligjit 108/2014 i ndryshuar “Për Policinë e Shtetit”.**

61. Në lidhje me rekrutimin pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (ish – SHÇBA), subjekti i vlerësimit i është nënshtruar procesit të konkurrimit, ku me shkresë (rezultatet e testimit të vendeve të lira me gradë) nr.***, datë 29.5.2020, ka rezultuar fitues. Gjatë hetimit është konstatuar se subjekti i vlerësimit, në momentin e aplikimit konkretisht në vitin 2020, ka mbajtur gradën “Kryekomisar” dhe pozicionin e Drejtor Drejtorie në nivel qendror në ish-

SHÇBA, ku ai është emëruar, në bazë të VKM 740, datë 5.11.2014, korrespondon me gradën “Drejtues i Parë”.

Gjatë zhvillimit të hetimit administrativ dhe shterimit të çdo paqartësie të lindur gjatë procesit, Trupa e Vlerësimit ka marrë në konsideratë çdo rrethanë dhe faktor të konstatuar e më konkretisht:

- Subjekti i vlerësimit gjatë kohës që ka qenë me detyrë pranë Policisë së Shtetit, ka kryer funksionin e analistit në cilësinë e informacionit kriminal.
- Subjekti i vlerësimit i është nënshtruar një seri trajnimesh në fushën specifike të trajtimit të analizës dhe cilësisë së informacionit, duke gëzuar kualifikime të nevojshme për pozicionin e punës që mbante pranë AMP-së (ish-SHÇBA-së).
- Gjatë periudhës 5-vjecare të vlerësimit dhe para saj, subjekti i vlerësimit ka mbajtur pozicione menaxheriale duke i dhënë këtij të fundit një formim profesional që i shërben pozicionit që mban në momentin e emërimit pranë AMP-së (ish-SHÇBA-së).

*****Trupa e Vlerësimit, referuar gjetjeve të sipërpërmendura si dhe faktit që emërimi i subjektit të vlerësimit është bërë sipas një konkursi nga një Komision që ka vlerësuar rrethanat e faktit, në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar e shkarkon subjektin e vlerësimit nga përgjegjësia, mbi mospërputhshmërinë e gradës dhe pozicionit që mban.**

62. Në përfundim të hetimit të kryer: Trupa e Vlerësimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit dhe Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, arrin në konkluzionin se:

Subjektin e vlerësimit Shkelqim Zuriqi;

- **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- **Ka vlerësime pozitive pune.**

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatorit të çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 22.12.2023, arrin në kokluzionin se subjekti i vlerësimit, Shkelqim Rexhep Zuriqi, në përputhje me nenin 60

të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Shkelqim Rexhep Zuriqi, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 22.12.2023, në Tiranë.

KRYESUES

KLEVIS DHIGOI

RELATOR

ERJANA PJETRI

ANËTAR

ERSA KARAJ